

DISKUTIMET PËR QEVERINË: ÇFARË E PRET KOSOVËN DITËT NË VIJIM?

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, është caktuar mandatar për ta formuar Qeverinë e re të Kosovës më 4 nëntor, kur edhe nisi afati 15-ditor për ta përmbyllur procesin. Por, deri më tani, sinjale për mbajtje të ndonjë seance në Kuvend nuk ka. Çfarë skenarësh ka përpara vendi?

TAKIMI I PARË I DURKEES ME THAÇIN: PAVARËSIA E KOSOVËS, OBJEKTIVI KRYESOR I UÇK-së F. 7



**BISLIMI I ANKOHET
SORENSENIT SE
SERBIA S'PO I PRANON
PAGESAT E KOSOVËS
PËR SHOQIPTARËT NË
LUGINË F. 3**



OPINION

MEMLI KRASNIQI! F. 7

Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



**KOSOVA RENDITET SI VENDI ME
NIVELIN MË TË ULËT TË KRIMIT NË
BALLKANIN PERËNDIMOR F. 6**

**DANEZI PETER DUE, SHEF I RI I
UNMIK-UT NË KOSOVË F. 3**

EKONOMI



**KOSOVA PRET ANËTARËSIMIN NË
SEPA PËR TË KURSYER MILIONA
EURO F. 8**

**KEDS-i ZVOGËLON HUMBJET E
ENERGJISË ELEKTRIKE NË 12.67 %
F. 8**

SPORT



**MURIC: LUFTOJMË PËR VENDIN E
PARË NË GRUP, DUAM MË SHUMË
SE 'PLAY-OFF'-i F. 11**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI NËNSHKRUAN PROJEKTLIGJIN PËR RIHAPJE TË QEVERISË AMERIKANE

WASHINGTON, 13 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump e ka nënshkruar projektligjin për rihapjen e qeverisë dhe përfundimin e mbylljes së saj më të gjatë në historinë e Shteteve të Bashkuara. Ai e ka nënshkruar dokumentin për ta financuar qeverinë deri në fund të janarit, pasi atë e kanë miratuar Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati.

Në Zyrën Ovale, Trumpi ka thënë se qeveria do t'i rinisë operacionet normale, pasi "njerëzit janë dëmtuar aq keq" nga mbyllja 43-ditore.

Shumë shërbime qeveritare janë

pezulluar prej tetorit dhe rreth 1.4 milion punëtorë federalë kanë qenë në pushim pa pagesë, ose kanë punuar pa paga.

Edhe ndihmat për personat me të ardhura të ulëta ishin pezulluar, si dhe trafiku ajror ishte çregulluar, me fluturime të anuluar apo të shtyra.

Shërbimet qeveritare pritet të rikthehen në ditët në vijim, ndërsa situata në trafikun ajror pritet të stabilizohet para Festës së Falënderimeve, kur shumë amerikanë kthehen në shtëpi.

Festa këtë vit shënohet më 27 nëntor. Besohet se edhe kjo datë ka ndikuar që kongresistët t'i rrisin

përpjekjet për të arritur një marrëveshje.

Presidenti Trump, republikan, e ka fajësuar vazhdimisht Partinë Demokratike për mbylljen e Qeverisë. "Ata e kanë bërë këtë për arsye të pastra politike. Kur të afrohen zgjedhjet për Kongres dhe gjërat tjera, mos e harroni çfarë i kanë bërë shtetit tonë", ka thënë ai.

Demokratët dhe republikanët nuk janë pajtuar me javë për paketën e financimit të qeverisë, mirëpo të dielën tetë demokratë janë shkëputur nga linja partiake dhe kanë ndihmuar në miratimin e projektligjit për hapje të qeverisë.



MBLEDHJA E QEVERIVE RAMA - MELONI, FIRMOSEN 16 MARRËVESHJET DHE MEMORANDUMET



ROMË, 13 NËNTOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se ai dhe homologia e tij italiane, Giorgia Meloni, kanë bërë shkëmbimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Italisë mbi bashkëpunimin strategjik.

Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë sektorë si kujdesi shëndetësor, energjia, mjedisi, industria e sigurisë dhe mbrojtjes, menaxhimi i migracionit, arsimi, inovacioni dhe të tjera. Kjo shënon mbledhjen e parë të përbashkët mes qeverive Shqipëri - Itali, ka bërë me dije Rama. "Romë - Shkëmbimi i Marrëveshjes

ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë mbi bashkëpunimin strategjik në kujdesin shëndetësor, energjinë, mjedisin, industrinë e sigurisë dhe mbrojtjes, menaxhimin e migracionit, arsimin, inovacionin, diasporën, transformimin ekonomik dhe rritjen e zgjuar", ka shkruar Rama në rrjetet sociale.

Ky format bashkëpunimi ndërqeveritar G2G shihet një risi në marrëdhëniet mes dy vendeve.

Kryeministri Rama në takimin në Romë e quajti homologen italiane Giorgia Melonin, motra e madhe, ku, sipas tij, ka

dashurinë që ta ndihmojë Shqipërinë. "Me thënë të drejtën, në të gjitha vitet që kam drejtuar Shqipërinë, nuk kam pasur kurrë asnjë dyshim mbi qëllimet e mira dhe dëshirën për të bërë të gjitha qeveritë italiane. Me këtë qeveri është dashuria dhe dëshira për të bërë dhe jemi shumë mirënjohës sepse jo vetëm motra e madhe e Italisë, por edhe ministrat e saj janë shumë të gatshëm për të ndihmuar. Dhe shpresoj të mos keqkuptohet se, falë angazhimit vëllazëror, sot jemi në gjendje të projektojmë në disa drejtime konkretisht për të fuqizuar aftësitë tona të mbrojtjes", ka theksuar Rama.

EUROPOL-I ARRESTON PJESËMARRËS NË KOMPLOTIN PËR RRËMBIMIN E NJË TRAFIKANTI SHQIPTAR TË DROGËS

HAGË, 13 NËNTOR - Agjencia Evropiane e Policisë [EUROPOL] ka bërë me dije se më 12 nëntor ka ofruar ndihmë në një hetim të kryer nga gjermanët, lidhur me një grup mercenarësh, të angazhuar nga një rrjet kriminal, me qëllim të kidnapimit të kreut të një bande rivale shqiptare për trafikim droge.

Kreu i kësaj bande shqiptare - emri i të cilit nuk është bërë me dije - dyshohet se e ka orkestruar vjedhjen e disa tonëve të kanabisit, në vlerë të miliona eurove.

Aksioni i koordinuar është fokusuar në shtetas të Letonisë, disa prej të cilëve ishin me prapavijë në Legjionin e Huaj Francez.

EUROPOL-i ka thënë se në

operacion janë përfshirë autoritetet për zbatim të ligjit prej Danimarkës, Francës, Letonisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. "Këta individë shumë të trajnuar kanë qenë të pajisur me pajisje profesionale dhe kanë qenë aktivë në emër të grupit të krimit të organizuar".

Në ditën e operacionit policor janë arrestuar katër individë në Danimarkë, Francë, Letoni dhe Mbretëri të Bashkuar, ndërsa dy të tjerë, që janë arrestuar në tetor të vitit 2014 në Gjermani, tashmë janë dënuar nga gjykatat.

EURPOL-i ka thënë në njoftim se ky operacion është i lidhur me fenomenin e ashtuquajtur "Dhuna si shërbim", që do të thotë se kryesit e krimit ofrohen



për t'i kryer aktet e dhunshme në emër të rrjeteve tjera kriminale.

Për organizatën evropiane, ky është një trend shqetësues, i cili është edhe rezultat i luftës në Ukrainë. "Ukrainasit e trajnuar

nga forcat amerikane, legionarët dhe mercenarët rusë, të gjithë ish-ushtarë të zonave të luftës, po kthehen nga fronti dhe po i shfrytëzojnë aftësitë e tyre për krim të organizuar. Teksa lufta në Ukrainë vazhdon dhe

potencialisht intensifikohet, Evropa mund të përballet me numër në rritje të këtyre individëve të përfshirë në aktivitete kriminale".

Prandaj, EUROPOL-i ka bërë thirrje që të vëzhgohen këto veprimtari dhe të bëhen përgatitje për sfidat që mund t'i sjellin.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për të çmilitarizuar Ukrainën. Përfundimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

MEMLI KRASNIQI!



Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA

Dorëheqje shkaku i integritetit, jo Ramizit: Pas balotazhit kam qenë i sigurt se Memli Krasniqi, pavarësisht rezultateve do të japë dorëheqje. Kjo PDK, me këtë miell që e ka nuk mund ta gatuj një pite më të mirë. Madje, nëse merren parasysh rrethanat që u krijuan, PDK-ja në kohën e Memli Krasniqit u nda shumë mirë, pabesueshëm mirë. Tash, qejfi është më i madh se Stambolli... Një parti që mbeti pa liderët emblematikë si Thaçi dhe Veseli është pritur të ketë rënie më të madhe e që nuk ndodhi me PDK-në në sajë të një pjese

idealiste të burgjeve dhe të luftës që, në heshtje ruajtën dhe mbrojtën shtyllën kombëtare të PDK-së dhe “kullerave”, siç u quajtën nga krokodilët pa dhëmbë veprues, Memli Krasniqi në nivel qendror dhe Uran Ismaili në atë lokal. Gjeneratat e vjetra me vështirësi i pranojnë ndryshimet e kohës shkaku se vuajnë nga reuma e karrierës prandaj përpëliten e përpëliten me qëllim të mos ketë lëvizje nga kënetat e mosveprimit dhe mbijetesës personale dhe dostave, zvarranikë permanent. Memli kishte kundërshtime gerentologjike (të pleqve partiakë) dhe kundërshtime të mediokërve përfitues dhe zhvatësve. Që nga lista për

deputetë e deri për kryetarë të komunave. Nuk jam pajtuar që Ramiz Lladrovci të eliminohet, e kam thënë publikisht. Mirëpo, nuk mund të fajësohet Memli ekskluzivisht për faktin se është votuar dhe se shumica ishte kundër “vëllaut Ramiz”. Ramizi pastaj nuk zgjodhi mjete për ta fituar Drenasin dhe e fitoi. Jo si PDK. Prandaj nuk ka të drejtë morale dhe materiale të merret me PDK-në duke kërcënuar publikisht se do “t’ia thejë shpinën”. Merreni me mend! Doli gjithashtu publikisht duke kërkuar “kokën politike” të Memli Krasniqit por jo edhe të Albin Kurthit (përfitoi vota nga ai), Lumir Abdixhikut apo Ramush Haradinajt. Me këtë veprim Ramizi u bë “yll” i

njerëzve më të ndytë të skenës politike kosovare, kryesisht të LV-së dhe qarqeve proserbe dhe projugosllave. Përnjëherë u kujtuan se qenka vëlla i heroit të kombit Fehmi Lladrovci dhe se qenka “Nëna e Patriotizmës..”. Prapa krahëve e përqeshin ligësisht. Ne, shokët e Fehmi Lladrovci kur nuk iu kemi ndarë veprës dhe kujtimeve për Fehën pavarësisht klimës dhe zhvillimeve politike. Jo si “shoqet” e LV-së, emisare të Kurthit që drekojnë me Ramizin për të përfituar shujta politike. Në emër të gjyshit patriot me të cilin e lidhë vetëm mbiemri, asgjë tjetër. Është 100 për qind e kundërta e gjyshit, servile e Kurthit dhe Dejona Mihalidis. Pasi Ramizi

ka marrë turr, për të mos e thyer qafën duhet dikush t’ia thotë një SHSHSHTË të madhe.

Për bindjen time Memli ka qenë në defansivë dhe pa mbrojtje efektive partiake në rastin e sulmit kriminal që e bënë besnikët e Kurthit në kutitë votuese në Mitrovicën e Jugut. Albin Kurthi ishte në krye të këtij inkursioni kriminal kundër vullnetit të votuesve duke ia vjedhur fitoren Arian Tahirit dhe duke e shpallur fitues një njeri të ligë dhe pa asnjë vlerë. Memli është dashur ta përzgjedhë një tjetër kandidat për Podujevë, Kamenicë dhe disa komuna të tjera.

Çka pas kësaj: Memli Krasniqi është thua 20 vjet në PDK, aty edhe do të mbetet. Është luftëtar i rryer dhe i vendosur politik me integritet të shkëlqyer njerëzor, moral, kombëtar dhe politik. Me një edukatë të shëndoshë familjare. Prandaj vendimi për dorëheqje ishte e vetmja zgjedhje dhe zgjidhje që shkon me integritetin e tij të kompletuar.

Bedri Hamza është i preferuar i të gjithëve, si shpëtimtar i PDK-së për zgjedhjet e ardhshme. Ta shohim. Nëse PDK-ja nuk e bënë një ristrukturim të brendshëm ku cilësia do të mbizotërojë mbi klientelizmin dhe nepotizmin dhe ku gjithëpërfshirja do ta mund regjionalizmin, nuk do të jenë mirë punët.

Më gjerësisht në një shkrim tjetër.

BISLIMI I ANKOHET SORENSENIT SE SERBIA S’PO I PRANON PAGESAT E KOSOVËS PËR SHQIPTARËT NË LUGINË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kryenegociatori i Kosovës për dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, ka thënë të enjten se e ka njoftuar të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian, Peter Sorensen, se një bankë serbe nuk po i pranon mjetet financiare që Kosova po i dërgon për t’i ndihmuar shqiptarët në jug të Serbisë. “Sot kam njoftuar z. Peter Sorensen, përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, lidhur me një çështje serioze që tashmë ka marrë karakter të pengesës sistemike ndaj të drejtave të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje. 3 650

fëmijë shqiptarë në Luginë janë duke përdorur 35 448 tekste shkollore të financuara nga Qeveria e Kosovës, pas kërkesës zyrtare të Këshillit Kombëtar Shqiptar. Qeveria jonë ka zbatuar plotësisht dhe në kohë të gjitha detyrimet e saj ligjore dhe institucionale”, ka shkruar Bislimi në “Facebook”.

Megjithatë, ai ka theksuar se pagesa përkatëse prej 304 511.16 eurosh, e destinuar për furnizimin me tekste shkollore, përkrahjen e aktiviteteve ndërkombëtare të avokimit dhe funksionimin institucional të KKSh-së, është bllokuar tri herë radhazi nga banka pranuese në Serbi. “Në të tre rastet, transferimi është refuzuar. Mjetet po refuzohen pa dhënë asnjë



arsye ligjore, teknike apo rregullatore. Pra ky nuk është gabim teknik. Kjo paraqet një model të qëllimshëm administrativ që synon ta pengojë mbështetjen e ligjshme dhe transparente për

komunitetin shqiptar në Luginë. E njëjta qasje është vërejtur edhe në anulimin e vendimit të KKSh-së për programin e subvencioneve bujqësore për fermerët shqiptarë, pavarësisht se të

gjitha procedurat ligjore dhe verifikimet ishin përfunduar plotësisht. Këto veprime nuk janë raste të izoluar, por tregues të një qasjeje të strukturuar të pengimit administrativ”, ka deklaruar Bislimi, duke shtuar se institucionet e Kosovës i kanë vënë në dispozicion Bashkimit Evropian të gjitha provat dokumentare: komunikimet SWIFT, kthimet e bankave dhe dokumentacionin e vendimeve qeveritare. “Kosova mbetet e përkushtuar ndaj procesit të dialogut, por nuk mund të qëndrojë indiferente kur mekanizmat administrativë përdoren për t’i cenuar të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje”, ka deklaruar Bislimi.

DISKUTIMET PËR QEVERINË: ÇFARË E PRET KOSOVËN DITËT NË VIJIM?

Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, është caktuar mandatar për ta formuar Qeverinë e re të Kosovës më 4 nëntor, kur edhe nisi afati 15-ditor për ta përmbyllur procesin. Por, deri më tani, sinjale për mbajtje të ndonjë seance në Kuvend nuk ka. Çfarë skenarësh ka përpara vendi?

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kosova i mbajti zgjedhjet parlamentare në shkurt të 2025-s, por viti lehtësisht mund të përfundojë pa një qeveri të re. Nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Glauk Konjufca, ka afat deri më 19 nëntor që t'ia propozojë Kuvendit përbërjen e re qeveritare për të parë nëse i ka votat e nevojshme për ta formuar ekzekutivin e ri.

Në ditën kur u caktua mandatar, Konjufca u bëri thirrje partive të tjera politike që t'i linin anash inatet dhe të votonin për një qeveri të përkohshme deri në prillin e vitit tjetër - kur i skadon mandati presidentes aktuale, Vjosa Osmani, por partitë e mëdha shqiptare e bënë të qartë se nuk kanë votë për të. Konjufca është mandatar i dytë i LV-së, pas kreut të partisë, Albin Kurti, që do të provojë të formojë qeverinë e re. Kjo parti, ndonëse ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet e fillimvitit, nuk ka siguruar mjaftueshëm vende në Kuvend për ta zgjedhur e vetme qeverinë.

“Kurti 2.5”, “Konjufca 1” apo tjetër?

Naim Jakaj, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), thotë për Radion Evropa e Lirë se beson që kabineti që do ta paraqesë Konjufca do të jetë i njëjtë me kabinetin e propozuar nga Kurti, dhe nëse përbërja dhe përkrahja politike nuk kanë ndryshuar, nuk pritet rezultat i ri në votim. “Në këto rrethana, konsiderojmë që e vetmja mundësi reale për një qeveri të re do të ishte një marrëveshje politike për ta prodhuar një qeveri teknike, me mandat të kufizuar, dhe me disa objektiva të qarta, të cilat tashmë janë problematike”, shprehet Jakaj, duke përmendur si më kritike: miratimin e buxhetit të shtetit dhe të disa komunave për vitin e ardhshëm, ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare që lidhet me Planin e Rritjes së Bashkimit Evropian, si dhe miratimin e buxhetit për Radiotelevizionin e Kosovës (RTK). Për dallim prej Konjufcës, që nuk është deklaruar në publik rreth formimit të qeverisë, Kurti tha ditë më parë se këtë javë mund të ketë më shumë hollësi

rreth procesit. Ai përsëriti qëndrimin e tij se nuk është mirë për Kosovën të ketë zgjedhje edhe në dhjetor, edhe në prill. “Deputetët e Republikës janë para përzgjedhjes: ose ‘Kurti 2.5’ deri në dhjetor, ose ‘Konjufca 1’ deri në prill. Por, pa asnjërën prej tyre nuk është e mundur”.

Pse nuk po thirret seanca?

Rëndom në Kosovë, seancat për formim të qeverisë janë mbajtur shpejt pasi është mandatar një figurë për kryeministër. Për Jakajn situata e tanishme është e pazakontë, dhe ai është i befasuar me Konjufcën. “Kam pasur pritje të tjera nga zoti Konjufca, që ai të jetë më i shpejtë dhe më dialogues me partitë tjera, në mënyrë që të gjejë një zgjidhje”.

Përveç mungesës së votave, në Kosovë flitet gjerësisht se një tjetër arsye për zvarritje të procesit është që koha e zgjedhjeve eventuale të përshtatet me pushimet e diasporës në Kosovë, diku rreth 28 dhjetorit.

Jakaj shpreson që presidentja do ta evitojë këtë datë, meqë është periudhë feste në pjesën më të madhe të botës. “Nëse zgjedhjet do të mbaheshin pas datës 24 dhjetor, do të përbënin problem, në kuptimin që të mos ketë prani ndërkombëtare për t'i monitoruar zgjedhjet e jashtëzakonshme”.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, nëse qeverinë nuk arrin ta bëjë as mandatar i dytë, atëherë presidentja Osmani duhet t'i shpallë zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre.

Vetë Osmani tha ditë më parë se u ka treguar krerëve të partive ish-opozitare që nëse nuk dëshirojnë ta pranojnë një nismë legislative të nisur nga ana e Qeverisë në detyrë për miratimin e ligjeve - sikurse ai për buxhetin ose Planin e Rritjes së BE-së - atëherë një kërkesë formale mund ta bëjë ajo në emrin e tyre, mirëpo fillimisht partitë duhet të kenë gatishmëri që ato ligje t'i votojnë në Kuvend.

“Ka mundësi të zgjidhet kjo çështje, mirëpo deri më tani nuk kam përgjigje”, u shpreh ajo.

Sipas presidentes, marrëveshjet ndërkombëtare në vlerë gati 1



miliard euro, buxheti i shtetit dhe çështje tjera do të duhej të votoheshin “nga përfaqësuesit e këtij Kuvendi, të cilët janë votuar më 9 shkurt të këtij viti, por akoma s’kanë vendosur asgjë”.

Çfarë nëse vendi shkon në zgjedhje?

Ekspertët parashikojnë që do të gjendet një mënyrë që

Kosova të ketë buxhet deri në fund të muajit mars të vitit të ardhshëm, ndërsa fondet e huaja rrezikojnë të humbin. Nëse pas 31 marsit s’ka institucione funksionale, atëherë vendi do të përballet me situatë të paparashikueshme, meqë nuk do të ketë paga për punëtorët e sektorit publik dhe as operatorët e sektorit privat nuk do të mund t'i kryejnë punët e tyre, në mungesë të

kryerjes së obligimeve nga ana e shtetit. Megjithatë, partitë vazhdojnë të mos gjejnë mes, dhe besojnë se zgjedhjet e parakohshme janë opsioni i vetëm real.

Njohësit e çështjeve politike, në anën tjetër, nuk presin ndryshime të mëdha në rezultate, dhe përsërisin që vetëm kompromisi e nxjerr vendin nga kriza. Mbetet të shihet kush do ta bëjë kthesën e madhe...

Nis punën komisioni i posaçëm për vlerësimin e fletëvotimeve në Mitrovicë

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se të enjten ka filluar punën komisioni për vlerësimin e fletëvotimeve që janë identifikuar me “gabime teknike” në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune në Mitrovicë të Jugut dhe në Gjakovë. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije se komisioni i porsaformuar është

duke zhvilluar punën në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve dhe pritet që raportin përfundimtar ta dorëzojë jo më vonë se data 14 nëntor. “Për komunat e tjera ky vlerësim do të bëhet sipas mostrës së caktuar dhe raporti do të finalizohet deri në fund të javës”, ka deklaruar Elezi, duke shtuar se “puna e këtij komisioni do të jetë në funksion edhe të përgjigjes së kërkuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe

Parashtresa” lidhur me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës. Pavarësisht se KQZ-ja ka pretenduar se “gabimet teknike” nuk e cenojnë integritetin e procesit zgjedhor, në publik janë hedhur dyshime se parregullsitë në printimin e numrave serikë të fletëvotimeve mund ta kenë krijuar mundësinë për deportimin e “trenit bullgar” në zgjedhjet lokale, posaçërisht në Mitrovicë të Jugut.



TAKIMI I PARË I DURKEES ME THAÇIN: PAVARËSIA E KOSOVËS, OBJEKTIVI KRYESOR I UÇK-së

HAGË, 13 NËNTOR - Ish-këshilltari politik i Wesley Clarkut, Michael Leroy Durkee, gjatë dëshmisë në Dhomat e Specializuara të Kosovës, ka sqaruar takimin e parë me Hashim Thaçin dhe objektivin që kishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ai ka thënë se kishte shumë pak shtete që e konsideronin UÇK-në si organizatë terroriste. “Sikurse e kemi mësuar në takimin e parë me Thaçin dhe të tjerët, objektivi i tyre kryesor ishte pavarësia e Kosovës, pra krijimi i një shteti të pavarur. Dua të kthehem një hap pas disa viteve, para se qeveritë perëndimore ta konsideronin UÇK-në si grup terrorist. Në fakt, kishte pak shtete që e kishin konsideruar UÇK-në të tillë”. Durkee shtoi se qëllimi ishte të fitohej mbështetja e NATO-s dhe Bashkimit Evropian. “U desh pak kohë që ata të fillonin ta shikonin Kosovën si një vend ku të gjithë njerëzit mund të jetonin në paqe dhe siguri, të ishin më të organizuar dhe më të disiplinuar. Mënyra se si ata e demonstironin këtë ishte përmes kontributit në uljen dhe minimizimin e pasojave negative të dhunës, gjë që kishte ndikim pozitiv si mbi shtetet anëtare, ashtu edhe mbi vetveten, për ta fituar mbështetjen e NATO-s dhe BE-së”. Durkee tha se ata kishin përshtypje se në Kosovë nuk kishte një strukturë të konsoliduar të komandës që të jepnin urdhra që të mos kryheshin veprime të caktuara në terren. “Ne kishim këtë



përshtypje që nuk kishte një strukturë solide ose të konsoliduar komandës që dikush të ishte në nivel të lartë në Prishtinë dhe të jepte urdhra të cilat më pas do të çonin në veprime ose në operacione të caktuara në terren nëpër zona operative. Komandantët e zonave operative kishin autonomi të konsiderueshme dhe ekzistonte vullneti i tyre për të vepruar me kokën e tyre kur ata e mendonin të përshtatshme”, tha Durkee. Kjo

nuk ishte në Kosovë ashtu siç është zakonisht në ushtritë perëndimore, sipas Durkee. “Domethënë nuk kishte një zinxhir të konsoliduar komande në kuptimin e koordinimit të drejtpërdrejtë të komandës siç domethënë në ushtrinë perëndimore”, deklaroi ai, raporton Betimi për Drejtësi. Durkee pohoi se ishte Hashim Thaçi njëri prej personave që thoshte se duhej të krijohet një Kosovë shumëtnike. Ai pohoi se Thaçi ka bërë një fjalim më 1999-

n duke bërë thirrje që të ndalohej dhuna. Durkee ka nisur dëshminë të mërkurën në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Gjykatën Speciale dhe e ka përfunduar të enjten. Para ish-këshilltarit të Clarkut, në Speciale ka dëshmuar ish-diplomati amerikan Christopher Hill. Dëshmitë e ish-zyrtarëve të lartë të periudhës së luftës në Kosovë mund të jenë element përcaktues për të vërtetën e luftës çlirimtare të UÇK-së, duke sfiduar

narrativën e Prokurorisë së Specializuar, sipas së cilës, UÇK-ja ka pasur një strukturë qendrore të konsoliduar që ka urdhëruar vrasjen e civilëve gjatë luftës në Kosovë. Katër ish-anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ndodhen në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020, ndërsa qëndrimi i tyre pesëvjeçar në Hagë është cilësuar si shkelje e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, së fundmi është zhvilluar edhe një protestë në Hagë.

LDK-ja ngreh shqetësimet rreth rastit korruptiv për rezervat shtetërore

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Alban Zogaj, dhe anëtari i kryesisë Berat Rukiqi, deklaruan të enjten se ky është një rast që prekë sigurinë kombëtare, financat publike dhe integritetin institucional të shtetit. Përderisa prezantuan edhe fakte të marra nga dokumenti i aktakuzës së ngritur. “Prokuroria Speciale e Kosovës ka përcaktuar, përmes

aktakuzës, se në këtë rast është shkakuar dëm prej rreth 3 milion euro ndaj buxhetit të Kosovës. Ky rast tregon, se pari, dështim serioz institucional dhe keqqverisje e korrupsion në nivelet më të larta të kësaj qeverie të udhëhequr nga LV-ja dhe Kurti”, u tha në një konferencë për medie nga këta dy zyrtarë të LDK-së. Lidhja Demokratike e Kosovës ka kërkuar transparencë të

menjëhershme nga qeveria në detyrë, përgjegjësi të plotë politike, jo vetëm juridike, duke përfshirë edhe kryeministrin në detyrë, si dhe hetim të plotë të këtij rasti dhe rasteve të ngjashme që lidhen me sektorin e energjisë, tenderët e shumtë sekretë dhe çështjen e marrjes së vendimeve të paligjshme nga qeveria dhe ministrat në detyrë.



PUNËTORËT E RTK-së KËRKOJNË PAGAT, NGA E HËNA FILLOJNË GREVËN NJËORËSHE

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Për të tretën herë punëtorët e Radio Televizionit të Kosovës (RTK) kanë dalë të enjten sërish në protestë, duke kërkuar ekzekutimin e pagave të tyre. Gjatë protestës kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Radio Televizionit të Kosovës (SPERTK), Gëzim Bimbashi, i bëri thirrje kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, të veprojë njësoj si në gusht të këtij viti dhe t'i sigurojë pagesat. "Gjendja në RTK është përkeqësuar, ndërsa institucionet po vazhdojnë të heshtin. Mbi 700 familje të punonjësve të RTK-së po përballen me probleme për mbijetesë. Presione nga bankat, detyrime për të paguar, ankth i përditshëm për të ardhmen. Kjo nuk është krizë ekonomike. Është krizë e identitetit", ka

thënë Bimbashi. Ai shtoi se situata mund të zgjidhet menjëherë pa asnjë vonesë me një vendim të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti. "Të gjitha justifikimet e tjera për komisione apo procedura të tjera janë beteja mes partish. Mos i fusni punëtorët e RTK-së në beteja politike. Ne nuk jemi pjesë e asnjë partie. Jemi punëtorë që kërkojmë atë që na takon me ligj", ka deklaruar tutje Bimbashi. Bimbashi tha se deri më tani nuk ka pasur veprime konkrete nga autoritetet dhe kërkoi ndërhyrje të menjëhershme. "Kemi dëgjuar deklarata, por asnjë veprim konkret. Prandaj, i bëjmë thirrje publike kryeministrit në detyrë Kurti që të veprojë ashtu sikurse herën e kaluar dhe të mundësojë



zgjidhjen e menjëhershme të situatës. Është e papranueshme që punëtorët nuk kanë marrë as njoftim nga menaxhmenti për

vonesë të pagave. RTK është pronë publike dhe e qytetarëve, e jo e partive politike. Ne do ta mbrojmë me dinjitet, unitet

dhe vendosmëri", tha ai. Punëtorët e RTK-së njoftuan se greva do të fillojë nga e hëna dhe do të zgjasë një orë, nga ora 11:00 deri në 12:00. "Greva do të fillojë nga e hëna në të gjithë RTK-në. Kërkojmë që nga kjo orë të mos punohet asgjë", tha Bimbashi. Ndërkaq Atdhe Hykolli nga BSPK që kishte dalë në mbështetje të protestës së punëtorëve të RTK-së ka thënë se zëri i punëtorëve duhet të dëgjohet. Në mbështetje të protestës ishte edhe kryetari i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Xhemajl Rexha. Ai tha se AGK qëndron në përkrahje të kolegëve të RTK-së, derisa bëri thirrje që qeveria të gjejë rrugë ligjore që punëtorëve të mediumit publik t'u ekzekutohen pagat.

SFIDA E PROKURORËVE PËR VEPRAT PENALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Me ftesë të koordinatores për rastet e dhunës në familje nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, njëherësh anëtare e grupit koordinues ndërmënisht kundër dhunës në familje, Laura Pula, është mbajtur takim në mes të koordinatorëve për këto vepra penale nga të gjitha prokuroritë themelore, si dhe udhëheqësit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Burhan Maxhuni. Në këtë takim u diskutua për sfidat me të cilat ballafaqohen prokurorët në punën e përditshme lidhur me trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me veprat penale kundër dhunës në familje dhe dhunës në bazë



gjinore dhe nevojën për ta bërë tejkalimin e këtyre sfidave. Nga të pranishmit diskutimet u fokusuan në zgjidhjen e problemeve të dhunës në familje, me theks të veçantë në trajtimin e personave që vuajnë nga probleme të shëndetit

mendor e që janë kryes të veprave penale të dhunës në familje, pastaj rastet e viktimave të ndjeshme, viktimat e përsëritura etj. Gjithashtu, u potencua rëndësia e bashkëpunimit institucional, në mënyrë që viktimat e dhunës në

familje të trajtohen me profesionalizëm dhe me dinjitet të plotë. Po gjatë këtij takimi u diskutua edhe për aktivitetet që do t'i zhvillojnë prokurorët e Shtetit dhe mbrojtësit e viktimave gjatë fushatës "16 ditët e aktivizimit

kundër dhunës me bazë gjinore". Edhe në këtë takim të gjithë prokurorët koordinorë potencuan se do ta vazhdojnë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe u zotuan që do të vazhdojnë me përkushtim edhe më të madh, me urgjencë dhe me efikasitet të trajtojnë të gjitha rastet që ndërlidhen me veprat penale kundër dhunës në familje. Në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe nëpër të gjitha prokuroritë themelore për rastet e dhunës në familje, janë të caktuar koordinorë nga radhët e prokurorëve, të cilët merren ekskluzivisht me këto raste dhe të cilët vazhdojnë me përkushtim dhe me urgjencë të trajtojnë të gjitha rastet që ndërlidhen me veprat penale kundër dhunës në familje.

KOSOVA RENDITET VENDI ME NIVELIN MË TË ULËT TË KRIMIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e të Gjitha Formave të Krimit të Organizuar Transnacional, më 10 nëntor është publikuar raporti Indeksi Global i Krimit të Organizuar 2025, i cili e nxjerrë Kosovën si vendi me nivelin më të ulët të kriminalitetit në Ballkanin Perëndimor. Indeksi Global i Krimit të Organizuar është tregues që mat dhe rendit vendet bazuar në përhapjen e krimit të organizuar dhe rezistencën e tyre ndaj krimit, po ashtu vlerëson edhe aktivitetet kriminale të tilla si trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimi kibernetik,

së bashku me aftësinë e një vendi për të luftuar këto kërcënime përmes qeverisjes, zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Sipas rezultateve të këtij indeksi për vitin 2025, i cili mat 15 tregje kriminale, 5 lloje aktorësh kriminalë dhe 12 blloqe të qëndrueshmërisë, të publikuar nga Global Initiative Against Transnational Organized Crime, Kosova vlerësohet me nivelin më të ulët të kriminalitetit në Ballkanin Perëndimor, me një mesatare prej 4.85 pikësh në një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 10. Një kontribuues kyç dhe i veçantë në arritjen e këtyre rezultateve pozitive është



Policia e Kosovës me leadershipin dhe zyrtarët e saj, e cila përmes planeve zhvillimore strategjike dhe objektivave të veçanta në luftimin e të gjitha formave të

krimit, ka rritur të ketë rezultate të theksuara ndër vite, e që e bëjnë Kosovën vendin me nivelin më të ulët të krimit në Ballkanin Perëndimor. Po sipas raportit të Transport

Community, i publikuar më 12 nëntor 2025, me të dhënat e vitit 2024, Kosova ka arritur rezultate pozitive edhe në sigurinë rrugore, duke pasur numrin më të ulët të viktimave për një milion banorë në aksidente fatale krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor. Policia e Kosovës përmes zbatimit të planeve operacionale, fushatave sensibilizuese e aktiviteteve të ndryshme policore, edhe në fushën e trafikut, ka arritur rezultatet më të mira krahas vendeve të Ballkanit Perëndimor. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në rritjen e mëtejme të sigurisë dhe parandalimin e aktiviteteve kriminale në nivel vendi.

"Kujtesa e një kombi që kërkon drejtësi", Osmani takon drejtorin e Institutit të Krimeve të Luftës

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shkruar lidhur me Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së kujtesës kombëtare dhe drejtësisë për viktimat e luftës. Ajo ka takuar drejtorin Atdhe Hetemi dhe ekipin e tij, ku ka theksuar se çdo jetë e humbur gjatë luftës është kujtesë e

dhimbshme dhe se pa mbrojtur të vërtetën, pa drejtësi dhe pa kujtesë, nuk mund të ketë paqe të vërtetë. "Kujtesa e një kombi që kërkon drejtësi. Instituti i Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë është zemra e kujtesës sonë kombëtare - vendi ku ruhet e vërteta për periudhën më të rëndë të historisë sonë. Me mijëra dëshmi të mbledhura e dokumentuara, ky institucion

mban gjallë kujtesën e krimeve të kryera nga Serbia ndaj popullit të Kosovës. Në takimin me drejtorin Atdhe Hetemi dhe ekipin e tij të përkushtuar, theksova se drejtësia për fëmijët, gratë dhe të gjitha viktimat e luftës është borxhi ynë më i madh si shtet dhe si shoqëri. Çdo jetë e humbur është kujtesë e dhimbshme se pa mbrojtur të vërtetën, pa



drejtësi dhe pa kujtesë - nuk ka paqe të vërtetë. Instituti nuk është vetëm arkiv - është

ndërgjegjja e kombit tonë, dëshmia e sakrificës mbi të cilën u ngrit liria jonë. Prandaj, e vërteta e dokumentuar do të dëgjohet dhe do të jetojë. Ftoj çdo qytetar, studiues, e çdo të ri të vendit të mbrojë dhe të ruajë këtë kujtesë. Sepse historia nuk harrohet - ajo tregohet e mbrohet, me dinjitet dhe me të vërtetën si themel", ka shkruar Osmani.

BARDHYL MAHMUTI: PREOKUPIMI IM ËSHTË FATI I ATYRE QË PADREJTËSISHT MBAHEN PRAPA GRILAVE NË HAGË, JO POZITAT PARTIAKE

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Veprimtari Bardhyl Mahmuti ka dalë me një reagim publik pas përmendjes se emrit nga Sadri Ramabaja në Debat Plus në TV Dukagjin si kandidat i mundshëm për kryetar të PDK-së pas dorëheqjes së Memli Krasniqit. Bardhyl Mahmuti në reagimin e tij ka theksuar se shpreson që drejtuesit legjitimë të PDK-së të kthehen sa më parë në Kosovë, duke pohuar se angazhimi i tij krahas aktiviteteve që lidhen me qëllimet e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur", për ta sensibilizuar opinionin rreth krimit të gjenocidit që ka kryer Serbia ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe veprave shkencore e letrare që ka publikuar për të ndriçuar këtë krim, preokupimi i tij është fati i çlirimtarëve që padrejtësisht mbahen prapa grilave në Hagë! "Të dashur miq. Pas dorëheqjes së z. Memli Krasniqi nga drejtimi i PDK-së, një numër gazetarësh më kanë kërkuar të jap përgjigje lidhur me përmendjen e emrit tim në Debat Plus në TV Dukagjin, nga Sadri Ramabaja. Për shkaqe objektive nuk kam mundur të jem pjesë e emisioneve që më është kërkuar, por po e bëj publik qëndrimin tim që ja kam dërguar gazetares Njomza



Pllana, të TV Dukagjinit", ka shkruar ai në "Facebook", duke nisur qëndrimin e tij me këtë titull: "Shpresoj që drejtuesit legjitimë të PDK-së të kthehen sa më parë në Kosovë!". "Krahas aktiviteteve që lidhen me qëllimet e Qendrës "Gjenocidi

në Kosovë-Plagë e hapur", për të sensibilizuar opinionin rreth krimit të gjenocidit që ka kryer Serbia ndaj shqiptarëve në Kosovë, dhe veprave shkencore e letrare që kam publikuar për të ndriçuar këtë krim, preokupimi im është fati i

njerëzve që padrejtësisht mbahen prapa grilave në Hagë! Nuk ka nevojë të rikujtoj se në Hagë mbahen përfaqësues legjitimë të institucioneve shtetërore dhe partiake të Kosovës. Rrjedhimisht edhe të PDK-së. Pa u lëshuar në arsyet

e dorëheqjes së z. Memli Krasniqi, unë respektoj të drejtën e çdonjërit të tërhiqet apo të konkurroj për drejtimin e partisë. Mirëpo, në rrethana që na ka imponuar procesi gjyqësor në atë që është bërë e zakonshme të quhet Gjykatë Speciale, çdo njëri që do të marrë drejtimin e të PDK-së, duhet ta ketë prioritet kryesor mobilizimi për ngadhënjimin e drejtësisë dhe lirimin e drejtuesve saj legjitimë. Përzgjedhja e dëshmitarëve të mbrojtjes së z. Hashim Thaçi ka dëshmuar një shkallë të lartë të profesionalizmit, duke shpartalluar tërësisht të gjitha shtyllat e sajara ku mbështetej Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës. Mbetem me shpresë që trupi gjykues do të peshojë në mënyrë të paanshme kredibilitetin e dëshmitarëve që solli mbrojtja dhe të hedhë poshtë dëshmitë e dëshmitarëve të akuzës, të bazuara në sajatat e Shërbimit Sekret të Serbisë. Jam i bindur në pafajësinë e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit! Uroj që të kthehen sa më shpejtë në Kosovë dhe të japin kontributin e tyre për uljen e tensioneve brenda shqiptare! Mirupafshim në protestën e 16 nëntorit 2025 në Strasburg!", ka shkruar Bardhyl Mahmuti.

Danezi Peter Due, shef i ri i UNMIK-ut në Kosovë

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, ka bërë me dije se ka emëruar Peter N. Due nga Danimarka përfaqësues të tij të ri special dhe shef të UNMIK-ut në Kosovë. Due pason Caroline Ziadeh nga Libani. Peter Due sjell në këtë pozicion 30 vjet përvojë të gjerë në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Që nga viti 2019 ai ka shërbyer drejtor për

Azinë dhe Paqësorin në Departamentet e Çështjeve Politike dhe të Ndërtimit të Paqes dhe Operacioneve të Paqes. Më parë, ai ishte drejtor për Azinë, Lindjen e Mesme, Evropën dhe Amerikën Latine në Departamentin e Operacioneve Paqeruajtëse (2015-2019). Due shërbeu gjithashtu përfaqësues i sekretarit të përgjithshëm dhe shef i Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Beograd (2013-2015) dhe ishte

zyrtar i çështjeve politike me UNMIK-un në Prishtinë. Në Nju-Jork pozicionet e tij kanë përfshirë gjithashtu shef zyre/asistent special i nënsekretarit të përgjithshëm për Operacionet Paqeruajtëse (2009-2013), udhëheqës ekipi për Afrikën Perëndimore (2008-2009) dhe udhëheqës ekipi për Evropën dhe Amerikën Latine (2008). Përveç detyrave të tij me Kombet e Bashkuara, Due shërbeu në Ministrinë e Punëve të Jashtme të

Danimarkës, në Kopenhagë dhe në Eritrea. Due ka një diplomë Bachelor dhe një diplomë Master në Filozofi, Politikë dhe Ekonomi nga Universiteti i Oksfordit, Mbretëria e Bashkuar; një diplomë D.E.S. (M.A.) në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare në Gjenevë, Zvicër; dhe një diplomë Cand. Mag. (M.SC.) në Shkenca Sociale dhe Filozofi nga Universiteti i Kopenhagës, Danimarkë.



Përveç gjuhës së tij amtare daneze, ai flet anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht.

KOSOVA PRET ANËTARËSIMIN NË SEPA PËR TA KURSYER MILIONA EURO

Bizneset dhe qytetarët në Kosovë paguajnë tarifa shumë më të larta për transferimet bankare ndërkombëtare, pasi vendi - i vetmi mes shteteve fqinje - nuk është pjesë e Zonës së Vetme të Pagesave në Euro (SEPA). Banka Qendrore e Kosovës ka përfunduar fazën e paraaplikimit për anëtarësim në SEPA, por procesi është pezulluar për shkak të shqyrtimit kushtetues të tri ligjeve.

Ekspertët vlerësojnë se anëtarësimi në SEPA do t'i ulë ndjeshëm kostot dhe kohën e transferove



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Për çdo transferim bankar deri në 10 mijë euro që bën jashtë shtetit nga bankat komerciale në Kosovë, ose që pranon nga jashtë, prodhuesi kosovar i pijeve “Frutex” paguan minimum 100 euro.

Pronari i kompanisë, Shaqir Palushi, thotë se kjo shumë zakonisht ndahet në mënyrë të barabartë: 50 euro i paguan kompania e tij kur pranon mjetet dhe 50 euro i paguan pala dërguese. Por, sipas tij, problemi nuk është vetëm financiar, pasi vonesat në pranimin e mjeteve janë të mëdha. “Mbërritja e mjeteve mund të zgjasë deri në pesë ditë pune. Kjo është ngarkesë për çdo biznes, që importon dhe eksporton mallra”, thotë Palushi për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, shkaku kryesor është fakti që Kosova nuk është anëtare e Zonës së Vetme të Pagesave në Euro - SEPA, prandaj komisionet janë shumë më të larta sesa në vendet që janë pjesë e këtij sistemi.

SEPA është një iniciativë e Bashkimit Evropian që lejon individët dhe bizneset të bëjnë pagesa në euro në mënyrë të

sigurt, të shpejtë dhe me tarifa të barabarta në të gjitha vendet anëtare. Aktualisht, SEPA përfshin 41 vende, mes tyre të gjitha vendet e BE-së, si edhe Zvicrën, Mbretërinë e Bashkuar, Norvegjinë dhe së fundmi Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Tarifat e larta prekin edhe qytetarët

Me probleme të ngjashme përballen edhe qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit. Blerim Ramadani, që punon në Gjermani, tregon se paratë për familjen në Kosovë i dërgon vetëm përmes kompanive të transferimit të parave, jo përmes bankave. “Vetëm një herë kam dërguar 7 mijë euro përmes bankës dhe babai im në Kosovë ka marrë 60 euro më pak. Tash përdor vetëm kompani shërbimesh financiare”, thotë ai. Në faqet zyrtare të dhjetë bankave komerciale që operojnë në Kosovë, komisionet minimale për transferimet ndërkombëtare variojnë nga 15 deri mbi 500 euro, në varësi të shumës, valutës dhe llojit të klientit -

individ apo biznes.

Transferimi i parave përmes kompanive të shërbimeve financiare, në shumicën e rasteve, është më i lirë dhe më i shpejtë dhe me kurs më të favorshëm valutor.

BQK drejt anëtarësimit në SEPA

Për t'i ulur kostot bankare, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka përfunduar fazën e para-aplikimit për anëtarësim në SEPA tek organi kompetent pranë Komisionit Evropian, në fund të vitit të kaluar. Sipas BQK-së, përfshirja e Kosovës në SEPA pritet të sjellë kursime vjetore prej rreth 55 milionë eurosh për qytetarët dhe bizneset.

Parakusht për anëtarësim në këtë mekanizëm është harmonizimi i kornizës ligjore vendore me atë të BE-së. Faza e para-aplikimit, sipas BQK-së, është realizuar më 14 tetor 2024 dhe është përditësuar më 20 dhjetor të po atij viti, pas miratimit në Kuvend të ligjeve përkatëse dhe 20 rregulloreve të reja të miratuara nga Bordi i

BQK-së. “Komisioni Evropian ka pranuar dokumentacionin, por aplikimi final mund të dorëzohet vetëm pas hyrjes në fuqi të ligjeve”, thuhet në përgjigjen e BQK-së dhënë Radios Evropa e Lirë.

Aplikimi final nuk është dorëzuar ende, pasi tri ligje të rëndësishme - Ligji për bankat, Ligji për shërbimet e pagesave dhe Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit - po shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, pas ankesës së Partisë Demokratike të Kosovës për shkelje procedurale gjatë miratimit. “BQK-ja është e përgatitur të procedojë me dorëzimin e aplikacionit përfundimtar për anëtarësim në SEPA dhe, në afatin e caktuar pas përshtatjeve teknike dhe infrastrukturore të sistemit bankar, të realizohet ndërlidhja me këtë zonë, duke adresuar edhe sugjerimet e natyrës teknike, të pranura nga komentet joformale të BE-së nga faza paraprake”, thuhet në përgjigjen e BQK-së.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës konfirmon për REL-in se çështja

e ligjeve në fjalë është ende në shqyrtim. “Vendimi do të merret pasi që të shqyrtohen të gjitha aspektet kushtetuese të pretendimeve të bëra në kërkesë nga pala parashtruese, në përputhje me Kushtetutën, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës së Gjykatës”, thuhet në përgjigje.

Ekspertët: Kursime të mëdha për qytetarët dhe bizneset

Sipas ekspertit financiar Nexhat Miftari, ish-shëf i kabinetit të guvernatorit të BQK-së, anëtarësimi në SEPA do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv për të gjithë. “Qytetarët që pranojnë remitenca apo transferime të tjera do t'u nënshtrohen tarifave shumë më të lira. Transferimet hyrëse dhe dalëse do të jenë më të shpejta, më të sigurta dhe më të lehta për t'u realizuar”, thotë Miftari për Radion Evropa e Lirë.

Ai shton se bankat në Kosovë janë tashmë të përgatitura teknikisht për t'u përshtatur me standardet e SEPA-s, pasi shumica e tyre vijnë nga shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Sipas Miftarit, përfitimet do të jenë të dukshme edhe për investitorët e huaj, megjithëse “zhvillimet politike dhe ekonomike aktuale nuk garantojnë një rritje të menjëhershme të investimeve të huaja direkte”.

Shembuj nga rajoni

Në rajon, Shqipëria dhe Mali i Zi janë bërë pjesë e SEPA-s më 7 tetor të këtij viti.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka deklaruar se komisionet për transferet bankare tashmë janë ulur në 1 deri në 3 euro për shuma prej 100 deri në 500 euro. Para anëtarësimit, për 100 euro, marrësi në Shqipëri merrte 88-90 euro, pasi bankat mbanin deri në 10 % të shumës.

Edhe Serbia dhe Maqedonia e Veriut janë bërë pjesë e sistemit SEPA në gjysmën e parë të këtij viti, duke lehtësuar pagesat ndërkufitare me euro në pjesën më të madhe të rajonit.

KEDS-i zvogëlon humbjet e energjisë elektrike në 12.67 %

PRISHTINË, 13 NËNTOR - KEDS-i ka arritur ta ulë ndjeshëm nivelin e humbjeve në rrjetin elektrik gjatë dhjetë muajve të parë të këtij viti. Sipas KEDS-

it, humbjet ranë në 12.67 % krahasuar me 13.29 % në të njëjtën periudhë të vitit 2024. “Ky përmirësim prej më shumë se gjysmë pikë

përqindjeje është rezultat i drejtpërdrejtë i aksioneve të pandërprera në terren gjatë gjithë kësaj periudhe me fokus në luftën kundër vjedhjeve të

energjisë elektrike, sikurse edhe masave të ndërmarra për modernizimin e rrjetit dhe forcimin e kontrollit teknik”, ka njoftuar KEDS-i.



SI E PUSHTUAN VAMPIRËT, PERËNDIMIN

Nga: Simon INGS
(*The Telegraph*)
Përkthimi: Telegrafi.com

Shën Kutberti jetoi në ishullin Lindisfarn duke u ushqyer me qepë të gjalla dhe vdiq në vitin 687. Katër shekuj më vonë, arkivoli i tij u hap dhe trupi i tij i ekspozuar dukej, për të gjithë, si një njeri i gjallë. Disa e shpallën menjëherë për mrekulli, por arkeologu dhe medievalisti John Blair nuk përmbahet pa pyetur: “A mund të ketë ngjallur brenga një kufomë që dukej si e gjallë”? Sipas Blairit, përmbledhja gjithëpërfshirëse e të vdekurve të gjallë ishte projekt të cilin e ruajti për pensionim. Vrasja e të

para Krishtit, neo-asirianët besonin se të vdekurit kishin nevojë për ushqim (ujë, birrë, hurma), dhe se shqetësoheshin kur injoroheshin. Qëndrimi i tyre goxha i matur kaloi në Greqi dhe që andej në Romë ku është përzier me disa ide, nga vendet aziatike, që besonin se të vdekurit merrnin formën e përbindëshave grabitqarë që ndryshonin në formë. Këto rrjedha folklorike u shtrembëruan dhe u errësuan teksa shkonin drejt Veriut, duke krijuar disa përbindësia madhështorë islandezë. Kolonizimi skandinav i përhapi këta “hakmarrës të stilit viking” në të gjithë Evropën Veriore, ku formësuan besimet në

sa kemi mundur të paramendojmë ndonjëherë. Por, çfarë i thërret të vdekurit e gjallë? Ata përhapen disi, kjo është e vërtetë, por nuk janë dukuri e përditshme. Në momentin e vetëm të paqartë të librit, Blairi thotë se shfaqjet e tyre “ndizen nga qëndrimet, perceptimet dhe frika që nuk janë automatike, por burojnë nga variablat shoqërore, ekonomike, politike, fetare dhe kulturore”. Kjo përkthehet në diçka mjaft të thjeshtë: rrethana të çuditshme lindin mendime të çuditshme. Luftërat, murtajat dhe polemikat fetare - të gjitha mund të ndikojnë që të dridhen muret midis të gjallëve dhe të vdekurve.

Dhe, pleqnarët diktatorialë mund të krijojnë një çudi të veten. Një matriarke rumune, shumë autoritare, qëndroi pezull jashtë dritares së të birit, me qefinin e saj të varrimit, për të shprehur mospëlqimin për martesën e tij. Komenti i djalit: “Njerëzit e dinin që nëna ime



“Makthi I” (1781) në koleksionin e Institutit të Artit të Detroitit Burimi: Fine Art Images/Getty

ishte e fortë dhe se gjykimi i saj ishte një barrë e rëndë për t’u përballuar. E dinin që ajo mund të kthehej”. Këto ditë ne e konsiderojmë vdekjen si një ngjarje të vetme - ironike, me të vërtetë, duke qenë se mjekësia jonë na përball shpesh me proceset e vdekjes. Shoqëritë e mëhershme nuk kishin njohje të madhe për

ringjallur i përket një vizionari fetar të dashur dhe ende të nderuar që u ngrit dhe la varrin e tij pasi vdiq. Jezu Krishti, sidoqoftë, gjithashtu arriti, në një stil goxha vampirik, të kalonte përmes gurit që mbante mbyllur varrin e tij. Nuk është për t’u habitur që disa nga të krishterët e parë “e panë si problem ringjalljen trupore”. Megjithatë, Blairi është më pak i interesuar për të gjetur të metat në atë që njerëzit panë; ai është më i interesuar për mënyrën se si njerëzit interpretuan atë që panë, dhe çfarë thotë kjo për idetë e tyre rreth jetës në përgjithësi. Në shoqëritë shamane, shpirtrat e rrjedhshëm lëviznin lirshëm brenda dhe jashtë materies: të jesh i gjallë do të thotë të jesh i pushtuar. Të krishterët dhe myslimanët e dërgojnë shpirtin e të vdekurit në vende të ndryshme hyjnore, ndaj mund të shpjegojnë ringjalljen vetëm përmes veprimeve ngacmuese të agentëve jashtëtokësorë - dhe me shumë gjasa djallëzorë.

Në fund të fundit (dhe disi në mënyrë të pabesueshme), historia e vampirit nga Blairi ofron frymëzim dhe ngushëllim. Të zhvarrosësh të vdekurit dhe t’ua presësh kokën me lopatë hekuri, kjo padyshim është një punë makabre, por shumë më pak e neveritshme sesa ta trajtosh një njeri të gjallë në të njëjtën mënyrë. Blairi argumenton bindshëm se vrasjet e kufomave janë parandaluese ndaj llojeve të histerisë në masë, që përndryshe djegin shtriga apo fusin fëmijë në furrë. “Si rituale të tjera ekstreme, është shqetësuese në momentin e ndodhjes, por njerëzit ndihen mirë pas saj”, është përfundimi i shkujdesur i Blairit: vrasja e kufomave është “normale”. Blair na udhëheq nëpër lugina të panumërta tmerri dhe na nxjerr përsëri duke u dridhur, por të padëmtuar, madje të ndriçuar me elanin e Uili Uonkës së Gene Wilderit (i cili, tani kur po mendoj, ishte një tjetër pensionist i remë). Nuk kërkoj ndjesë - nëse nuk e jap unë këtë lëvdatë, kush do ta bëjë këtë? – por Vrasja e të vdekurve është një libër për të cilin vlen të vdesësh. /Telegrafi/



“Vampiri (Dashuria dhe Dhimbja)” nga Edvard MunchBurimi: Fine Art Images

vdekurve [Killing the Dead] është rezultati i një jete të tërë mbushur me thesare djallëzie; qasja e Blairit ndaj kësaj i afrohet - dhe kush mund ta fajësojë? - një kënaqësie heretike. Si të mos tërhiqesh nga diskutimet mbi “mumiet dhe gratë-hiena epshore” të Kinës, apo nga titujt e kapitujve si “Të shtrirë të pavdekur në një hendek: Angli, 700-1000”?

Duke na bartur nga paniku për kufomat në Mesopotami deri në Pensilvani dhe Anglinë e Re, historia e Blairit ndjek pyetjen: a janë të vdekurit e gjallë një histori që ia tregojmë njëri-tjetrit, apo një fenomen i vërtetë? A është thjesht histeri ajo që duhet të fajësohet kur fshatarët nisen në një valë të vrasjeve të kufomave?

Injorantët do ta quajnë “mashtrim”, meqë titulli përmend vampirët, ndërkohë që libri përfshin të gjitha llojet e të vdekurve të gjallë. Por, Blairi mendon se vampirët, ashtu siç kuptohen zakonisht, janë një shpikje letrare dhe relativisht e re. Romani ynë i parë i vërtetë për vampirët është pamfleti i viti 1600, tani i humbur, që përmban tregimin e bujshëm për Johan Kuncin e Benishit. Të gjithë e dinë se vampirët janë sllavë, por, thotë Blair, diskutimet historike mbi fenomenin “e kanë theksuar në mënyrë të tepruar pirjen e gjakut”. Rezulton se që nga shekulli VIII

Gjermaninë e Veriut, në Poloni dhe në Bohemi. “Një epidemi intensive e vrasjes së kufomave shpërtheu gjatë viteve 1546-1553, në një sërë qytetesh të vogla saksone”, nxitur, siç duket, nga shpërthimet e përsëritura të murtajës bubonike.

Në mars të vitit 1732, fshatarët në Serbi zhvarrosën disa kufoma dhe, duke i parë të freskëta dhe të fryra nga gjaku, i masakruan dhe i dogjën. Autoritetet ushtarake të habsburgëve hetuan dhe hartuan një raport që, së bashku me fjalën “vampir”, përfundoi në gazeta që nga Parisi deri në Londër. Pra, edhe pse vampirët janë më të rinj sesa mendojmë, nuk ka nevojë për zhgënjim: prejardhja e tyre është shumë më e pasur dhe më e ndryshme nga



Një ilustrim nga botimet e lira të popullarizuara, “Vampiri Varni dhe festa e gjakut”Burimi: Hulton




“Vampiri”, nga Henry Louis Stephens, marrë nga “Historia e natyrshme komike e racës njerëzore” (1851)Burimi: Heritage Art

komën, anoksinë, vdekjen cerebrale dhe gjendjet vegetative, por ato qëndronin shumë më afër realitetit (dhe ofronin më shumë ngushëllim për të pikëlluarit) nëse e shihnin vdekjen si një proces, jo si një ngjarje. “Ndalimi i frymëmarrjes, shtrirja, faza kalimtare gjatë ceremonisë, varrimi dhe kalbëzimi fizik që pason janë hapa në një rrugë që duhet ndjekur me përpikëri”, thotë Blair për ato rite - i vetmi problem është se “nëse ajo rrugë pengohet, pasojat mund të jenë të tmerrshme”.

Përveç kur nuk janë. Fundja, trupi më i paharrueshëm i

SA SHUMË URI (DHE ETJE) KA INTELIGJENCA ARTIFICIALE

Inteligjenca artificiale ka rritur ndikimin ekologjik të qendrave të të dhënave që e përdorin, duke konsumuar gjithnjë e më shumë energji elektrike dhe ujë. Dhe ka nga ata që duan t'i zhvendosin ato nën det... ose edhe në hapësirë



Konsumojnë më shumë energji elektrike se tëra kombe të tëra. Nuk bëhet fjalë për uzina çeliku apo industri kimike, por për ruajtësit e të dhënave tona digjitale. Gjigantët e teknologjisë – Google, Amazon, Meta, Microsoft – janë të uritur për energji. Në vitin 2022 ata ishin ndër blerësit më të mëdhenj globalë të energjisë, menjëherë pas prodhuesve të çipave elektronikë. Për të siguruar furnizimin me energji elektrike, kompanitë nuk kanë kursyer shpenzimet: Google ka investuar në centralin më të madh diellor me pasqyrë, Ivanpah, në shkretëtirën Mojave të Kalifornisë, me gati 180 mijë pasqyra që prodhojnë 392 megavat energji. Amazon është blerësi më i madh në botë i energjisë së gjelbër, me 33,6 gigavat orë – më shumë sesa prodhon Ekuadori në një vit. Të tjerë po drejtojnë vëmendjen nga energjia bërthamore, madje me zgjidhje të guximshme: Microsoft ka zhytur qendra të dhënash nën det, ndërsa Thales Alenia Space ka paraqitur një projekt të financuar nga Komisioni Europian (2 milionë euro) për të vendosur qendra të dhënash në orbitë rreth Tokës. Por pse kjo etje për energji? Dhe çfarë pasojash do të ketë ajo për mjedisin dhe ekonominë?

Video, foto, dokumente... dhe një oreks i pangopur

Dihej prej kohësh që kompanitë Big Tech janë konsumatorë të mëdhenj energjie. Vetëm kërkimet ditore në Google në të

gjithë botën përdorin 2.55 milionë kilovat orë në ditë. Kjo është energjia e nevojshme që një kërkim i thjeshtë (“shtëpi me qira në Romë”) të japë një përgjigje. Paketat e të dhënave kalojnë përmes qendrave të mëdha të të dhënave (data centers), që janë hangarë gjigantë plot me serverë që përpunojnë kërkimet dhe japin rezultatet. Aty ruhen videot, fotot, dokumentet tona “në cloud”, madje edhe regjistrat e kriptovalutave. Energjia duhet të jetë e garantuar 24 orë në ditë, çdo ditë të vitit, ndaj këto qendra kanë gjeneratorë rezervë me naftë ose bateri. Ajo energji nuk ushqen vetëm serverët dhe ruterat, por edhe sistemet e ftohjes, që mbajnë procesorët në temperatura të sigurt. Me ardhjen e inteligjencës artificiale, situata është përkeqësuar ndjeshëm: një kërkim në ChatGPT konsumon 10 herë më shumë energji se një kërkim i zakonshëm, sepse përfshin shumë më tepër llogaritje komplekse. “Çdo përgjigje e ChatGPT,” shpjegon Marco Aldinucci, drejtor i grupit të llogaritjeve paralele në Universitetin e Torinos, “nënkupton miliarda operacione matematikore. Sa më i ndërlikuar të jetë modeli, aq më shumë energji kërkohet për të gjeneruar një tekst apo imazh.” Në këtë mënyrë, vetëm ata që do të kenë mjaftueshëm energji do të mund të marrin pjesë në garën për zhvillimin e AI-së më të avancuar. Dhe kjo pritët të ketë pasoja serioze. Sipas raportit të fundit të Agjencisë Ndërkombëtare të

Energjisë (IEA), deri në vitin 2026 kërkesa për energji elektrike nga qendrat e të dhënave pritet të dyfishohet, nga 460 teravat orë në 1.050 TWh – më shumë sesa konsumon Japonia në një vit.

Gara për energji

Në dekadën e fundit, kërkesa për energji nga qendrat e të dhënave është rritur me 14% në vit, ndërkohë që kërkesa e përgjithshme botërore është rritur vetëm me 2.5%. Energjia e gjelbër nuk mjafton — era dhe dielli janë të paqëndrueshëm, hidrocentralet dhe burimet gjeotermale nuk mund të ndërtohen kudo. Zgjidhja më e menjëhershme? Energjia bërthamore. Në qershor, Amazon bleu furnizim të drejtpërdrejtë me energji nga centrali bërthamor Susquehanna afër Filadelfias. Por operatorët e rrjetit energjetik amerikan e kundërshtuan marrëveshjen, sepse data center-i u klasifikua si “përdorues i zakonshëm”, duke shmangur pagesa të larta për transmetimin e energjisë (rreth 140 milionë dollarë në vit). Kritikët paralajmërojnë se zhvendosja e energjisë bërthamore drejt qendrave të të dhënave mund të rrisë çmimet për konsumatorët e zakonshëm. Në Evropë tashmë janë vendosur rregulla të repta: operatorët janë të detyruar të raportojnë konsumin e energjisë dhe ujit. Në gusht, autoritetet në South Dublin (Irlandë) refuzuan kërkesën e Google për një qendër të re të


dhënash, me arsyetimin se “rrjeti elektrik nuk e përballon dot ngarkesën shtesë”. Ndërkohë, Sam Altman (OpenAI) ka investuar në kompaninë Oklo për mikro-reaktorë bërthamorë, dhe Bill Gates ka financuar TerraPower, që zhvillon reaktorë të rinj të shpejtë. Por a po ringjallin data center-at energjinë bërthamore? Jo, sipas studiuesit italian Nicola Armaroli: “Bota po ecën drejt energjive të rinovueshme. Reaktorët modularë të vegjël nuk janë ende një opsion i disponueshëm. Kompjuterët kuantikë mund të reduktojnë ndjeshëm konsumin në të ardhmen”.

Problemi tjetër: uji

Data center-at përdorin sasi të mëdha uji për ftohje – rreth 43 kilometra kub në vit, gati sa 1.5 herë konsumi vjetor i Italisë. Uji avullon në kullat ftohëse që ftohin procesorët e mbinxehur. Për të reduktuar ndikimin mjedisor, Microsoft testoi një zgjidhje origjinale: zhytjen e një qendre të dhënash në det, në një kapsulë metalike hermetike 35 metra nën sipërfaqe, pranë brigjeve të Skocisë. Projekti Natick (2018–2020) tregoi rezultate të jashtëzakonshme: nga 855 serverë, vetëm 6 u dëmtuan (0.7%) kundrejt 6% në tokë. Arsyeja? Mungesa e oksigjenit, lagështisë dhe pluhurit, që shmangin gërryerjen. Megjithatë, projekti u mbyll. “Mësuam shumë nga kjo përvojë”, deklaroi Microsoft, “dhe do t'i përdorim këto mësimet në projekte të tjera.”

Qendrat e të dhënave... në orbitë

Edhe më ambicioz është projekti Ascend i Komisionit Europian: vendosja e qendrave të të dhënave në hapësirë. Kompania Thales Alenia Space ka propozuar ndërtimin në orbitë (1.400 km lartësi) të 13 moduleve gjigante, secili 200 metra i gjatë, të mbuluar me panele diellore gjashtëkëndore që do të prodhonin 10,4 megavat energji – mjaftueshëm për 3.500 apartamente. Mirëmbajtja do të kryhej nga robotë lëvizës dhe komunikimi midis moduleve përmes një rrjeti me brez të gjerë. Megjithëse projekti është teknikisht i mundshëm, nuk është ekonomikisht dhe ekologjikisht i qëndrueshëm: transportimi i materialeve në orbitë është tepër i shtrenjtë dhe prodhon shumë CO₂. Sipas inxhinierit Damien Dumestier nga Thales Alenia: “Që një sistem i tillë të jetë konkurrues me qendrat tokësore, duhet të kushtojë nën 80 milionë euro për bllok dhe të emetojë jo më shumë se 14 tonë CO₂ për nisje. Kjo do të jetë e mundur vetëm kur të kemi një gjeneratë të re raketash ekologjike, që parashikohet të jenë gati deri në vitin 2035.” Microsoft ka investuar ndërkohë 40 milionë dollarë në startup-in Armada, që synon të krijojë qendra të dhënash në hapësirë të lidhura me rrjetin Starlink. Në të ardhmen, ndoshta, të dhënat tona do të fluturojnë mbi kokat tona. / Focus – Bota.al



Hoxha me kontratë të re te Dinamo

ZAGREB, 13 NËNTOR - Sulmuesi i krahut, Arbër Hoxha, së shpejti do ta firmosë kontratën e re afatgjatë me Dinamon e Zabregit, kanë raportuar mediet në Kroaci. Është bërë me dije se palët tashmë kanë arritur marrëveshjen, e cila pritet të

bëhet zyrtare brenda këtij muaji. Në fakt, është thënë se Hoxha është shpërblyer me kontratën e re pas paraqitjeve fantastike që i ka treguar këtë sezon me fanellën e klubit të madh kroat. Kontrata e re do të jetë valide deri në verën e vitit 2029, ndërsa Hoxha do të

ketë pagë vjetore prej 500 mijë eurosh. Kontrata aktuale i skadon Hoxhës në vitin 2027, ndërsa ai i është bashkuar Dinamos në vitin 2024 nga Slaven Belupo për 1 milion euro dhe deri më tani, 27-vjeçari për ekipin nga Zagrebi ka

shënuar 8 gola dhe ka bërë 9 asistime në 79 paraqitje në të gjitha garat. Këtë sezon Hoxha ka 3 gola e po asistime në 16 ndeshje të luajtura, kurse gjatë verës pati interesim për transferimin e tij nga Italia, Anglia e Turqia.



MURIC: LUFTOJMË PËR VENDIN E PARË NË GRUP, DUAM MË SHUMË SE 'PLAY-OFF'-i

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Portieri i Kosovës, Arijanet Muriç, synon një garë "dhëmbë për dhëmbë" me Zvicrën për vendin e parë në grupin kualifikues të Kupës së Botës 2026. Në një "podcast" të publikuar në kanalin zyrtar të Federatës së Futbollit të Kosovës në "YouTube", Muriç ka thënë se objektivi i tyre është vendi i parë në grup, duke

theksuar se ekipi po kalon një formë të mirë fizike dhe psikologjike dhe ka gjasa reale për fitore në ndeshjen kundër Sllovenisë. Megjithatë, gardiani i Sassuolos ka shprehur keqardhje që nuk do të mund të luajë për shkak të pezullimit me kartonë. "Kam besim të plotë te portierët e tjerë. Ata stërviten njësoj si unë

dhe japin maksimumin çdo ditë për t'u përmirësuar. Jam i sigurt që janë gati", është përgjigjur Muriç kur është pyetur nëse beson te bashkëlojtarët e tij në portë. Kombëtarja e Kosovës nesër (e shtunë) do ta zhvillojë ndeshjen e parafundit të kualifikimeve për Botërorin kundër Sllovenisë.



BASHKIMI ARRIN FITORE TË MADHE, MPOSHT EKIPI E NJOHUR ITALIAN

PRIZREN, 13 NËNTOR - Bashkimi ka arritur një fitore të madhe në arenën evropiane, duke triumfuar me rezultat të ngushtë 77:76 ndaj skuadrës italiane Pallacanestro Reggiana në kuadër të xhiros së pestë të Grupit J në FIBA Europe Cup. Sfida e zhvilluar në palestrën "Sezai Surroi" ka përfunduar me një skenë spektakolare, një bllokadë vendimtare nga qendra amerikane De'Quon Lake, që ka ndalur tentimin e

fundit të Jaime Echenique dhe ka vulosur fitoren për skuadrën portokalli. Ndeshja ishte një betejë e vërtetë nervash, me ritëm të lartë dhe ndryshime të shpeshta në rezultat. Gjatë gjithë takimit asnjë ekip nuk ka arritur të shkapëtej ndjeshëm, ndërsa fundi ishte i denjë për film sportiv. Një minutë e 19 sekonda para fundit, TJ Bickerstaff ka shënuar të dyja gjaujtjet e lira për ta kaluar



Bashkimin në epërsi 76:75. Italianët kanë tentuar të riktheheshin, por kanë humbur disa aksione të rëndësishme, ndërsa Jeremiah Bailey ka realizuar për 77:76, vetëm 11 sekonda para fundit. Në aksionin e fundit të ndeshjes, Reggiana ka kërkuar fitore me një goditje të shpejtë, por Lake ka ndërhyrë në mënyrë perfekte, duke bllokuar topin dhe shpëtuar Bashkimin. Me këtë fitore,

ekipi prizrenas arrin suksesin e dytë në grup, duke u barazuar me vetë Reggianan, të dyja me bilanc 2-3. Ndërkohë, Dijoni dhe Cibona kryesojnë me nga tri fitore dhe dy humbje, por Bashkimi mbetet fuqishëm në garë për kalimin në fazën tjetër. Ndërsa Trepça ka vazhduar serinë e rezultateve negative në garat evropiane, duke u mposhtur në udhëtim nga Braunschweig me rezultat 80-70.

GJYQITARË NGA FRANCA NDAJNË DREJTËSINË NË NDESHJEN SLLOVENI - KOSOVË



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Nesër (e shtunë) prej orës 20:45 në stadiumin "Stožice" në Lubjanë do të luhet ndeshja Slloveni - Kosovë e cila i takon Grupit B kualifikues për Botërorin 2026. Për këtë

përballje të rëndësishme dhe, po ashtu, vendimtare, UEFA tashmë ka caktuar zyrtarët e ndeshjes, të cilët do ta ndajnë drejtësinë, ku në mesin e tyre do të jetë edhe një femër. Bëhet fjalë

për arbitra nga Franca, ku në krye të tyre do të jetë Clement Turpin, si gjyqtar kryesor i takimit. Ndihej të Turpinit, të cilët do t'i asistojnë janë Nicolas Danos e Benjamin Pages, ndërsa

Stephanie Frappart do të jetë gjyqtare e katërt. Në dhomën e VAR-it, Jerome Brisard do të jetë kryesori, kurse do të asistohet nga Jeremie Pignard i cili do të jetë në AVAR.

Anelotti: Jam i sigurt se Ronaldo do t'i arrijë 1 000 gola, pres të festojmë bashkë

BRASILIA, 13 NËNTOR - Trajneri italian Carlo Ancelotti ka shprehur besim të plotë në arritjet e ardhshme të lojtarit që dikur e stërviste te Real Madridi. Duke folur në podcastin "The Rest Is

Football", trajneri i ekipit kombëtar të Brazilit është përgjigjur me humor kur është pyetur nëse sulmuesi portugez mund të arrijë pikën e 1 000 golave. "Cristiano patjetër do të arrijë 1 000 gola, por kur ta bëjë

këtë, më mirë të mos harrojmë të më ftojë në festimin e këtij rekordi të pabesueshëm", ka thënë Ancelotti. Ancelotti ka folur edhe për Luka Modricin, duke vënë në dukje se kroati vazhdon të

performojë në nivelin më të lartë në Milano pavarësisht moshës së tij. "Lojtarë si këta gjithmonë arrijnë atë që synojnë falë talentit dhe punës së tyre të palodhur", ka thënë Ancelotti.



F2.2/BNJ



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" SH. A

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno član 8; na osnovu Uredbe br. 07/2024 o radnom odnosu u KRM "Pastrimi" a.d.; na osnovu Odluke Upravnog odbora KRM "Pastrimi" a.d. Protokol 01/14/41 od 30.10.2025. godine o pokretanju postupka zapošljavanja za javnu objavu za određena radna mjesta i dužnosti; na osnovu Odluke 01/14/42 o ispravci Odluke br. 01/14//41 i na osnovu Odluke glavnog izvršnog direktora sa br. Protokolom 02/01/848 od 12/11/2025 najavljuje se sledeće:

JAVNI KONKURS
ZA SPECIFIČNE POSLOVE I ZADATKE
Za popunjavanje posla

Naziv radnog mesta: Sertifikovani računovoda
Ne. Potreban: Jedna (1) pozicija, u KRM "Čišćenje" AD. A
Referentni broj: KJ / DS / DF / 33-2025
kvota / Mesečna plata: 900 evra bruto
Trajanje ugovora o radu: 6 meseci

1. Dužnosti i odgovornosti:

- 1.1 Analizira pozicije finansijskih izveštaja;
- 1.2 Identifikuje potencijalne greške računovodstvenih unosa i pomaže da ih ispravi;
- 1.3 Daje preporuke za poboljšanje efikasnosti rada u kompanijama;
- 1.4 Pomaže timu u proveru i podnošenju poreza;
- 1.5 Priprema finansijske izveštaje u skladu sa potrebnim standardima;
- 1.6 obavlja druge poslove za koje je ovlašćen od strane glavnog izvršnog direktora i glavnog finansijskog direktora i trezora;
- 1.7 On / ona je odgovoran glavnom finansijskom i trezorskom službeniku za svoj rad;

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- ✓ Državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poznaje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da obavlja relevantan zadatak;
- ✓ Ne biti osuđen za počinjenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- ✓ Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- 1. Potrebno obrazovanje: Osnovne studije iz ekonomije, sertifikat sertifikovanog računovođe
- 2. Potrebno radno iskustvo: Najmanje 3 godine u računovodstvu

4. Znanja, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- ✓ Veštine logičkog zaključivanja i analize;
- ✓ Komunikacijske vještine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- ✓ istraživačke, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- ✓ Sposobnost donošenja nezavisnih profesionalnih presuda i diskrecije o pitanjima i značajnog doprinosa razvoju i implementaciji politike;
- ✓ Veliko znanje iz oblasti, istraživačkih metoda, koje pomažu u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose kao deo prijave i kako ih dostaviti

Zahtev za zapošljavanje i CV, popunjen i potpisan od strane kandidata	✓
Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova	✓
Kopije dokaza o zaposlenju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Identifikacioni dokument Republike Kosovo	✓
Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci	✓

5.1 Posebni dokumenti

- Računovodstveni sertifikat

6. Kako se prijaviti na konkurs i poslati prijavu:

6.1 Povlačenje zvaničnih obrazaca se vrši:

- * preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Regionalno preduzeće za otpad "Pastrimi" a.d.
- * na recepciji kompanije.

6.2 Podnošenje prijave:

- * Prijava za zapošljavanje, sa popunjenom dokumentacijom, podnosi se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i
- * U slučajevima internih i eksternih takmičenja za tehničke pozicije, to se može uraditi i u fizičkom obliku preko arhive kompanije.

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 8 dana od 14.11.2025. do 21.11.2025. godine.
Rok za prijem prijava je 16:00 časova.
Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće biti razmatrane.

8. Metod evaluacije i kriterijumi ocenjivanja.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prohodnost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog takmičenja.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:

- ✓ Pismeni test: do 60 bodova
- ✓ CV kandidata: do 10 bodova
- ✓ Intervjuisanje: do 30 bodova.

9. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza prethodne verifikacije prijava do 7 dana;
Pismena faza testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,
Faza intervju a do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata vrši se do 3 dana nakon evaluacije intervju a.

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji stignu nakon isteka roka za dostavu konkursa, neće biti pregledani.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Weng Fat Poultry” shpk, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për “Fabrikën e përpunimit të mishit të shpezëve”, në Z.K. Polac, Skenderaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.12.2025 në ora 10:00 në Objektin e ShFMU "Drenica" ne Polac, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Weng Fat Poultry” shpk, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/9072254231?pwd=QjhTUE1yMVFCbTBLR3laU2xEQkx0Zz09>

Meeting ID: 907 225 4231

Passcode: N3hASu

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Weng Fat Poultry” shpk, Skenderaj, për Pëlqim Mjedisor, – për “Fabrikën e përpunimit të mishit të shpezëve”, në Z.K. Polac, Skenderaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L